TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. III/14
Dt. 15.03.2022
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos
Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2021

Vendimi: Nr. *III/14*

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2021 në mbledhjen Nr. 37 të mbajtur më datë 15.03.2022

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor SHALA** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Ramush AHMETAJ** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		
Data:	**15.02.2022**	**15.03.2022**

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2021



Fushë Kosovë,
Shkurt 2022

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	4
II.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
II. 1	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	6
II. 2	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten	8
II. 3	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	9
II. 4	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a	10
III.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	11
III. 1	Ngjarjet kryesore të vitit	13
IV.	PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE	15
IV. 1	Transporti i Mallrave	15
IV. 2	Transporti i Udhëtarëve	19
IV. 3	Zyra e Mirëmbajtjës së Mjeteve Lëvizëse	22
V.	PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET	25
V. 1.	Gjendja financiare	25
V.1.1	Të hyrat	25
V.1.2	Shpenzimet	26
	Të hyrat dhe Shpenzimet Operative	27
V. 2	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2021)	29
V. 3	Bilanci i gjendjes	30
V.	Transaksionet e realizuara	31
VI.	PROJEKTET KAPITALE	32
VII.	ZHVILLIMI I BIZNESIT	34
VII.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	34
VII.2	Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera	36
VII.3	Aktivitetet e Marketingut	37
VII.4	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore	37
VII.5	Sfidat dhe rreziqet e të ardhmes së korporatës	37
VIII.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A	39
IX.	ZYRA LIGJORE	41
IX.1	Kontestet gjygjësore	41
IX. 2	Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2021	42
X.	PËRFUNDIM	43

I. ANEKS RAPORTI

Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet

Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021

Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2021, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar. Megjithatë, ndërmarrja gjatë këtij viti është ballafaquar me një sfidë shumë të madhe siç është pandemia COVID 19, e cila vazhdon të jetë akoma prezent jo vetëm në vendin tonë. Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK-Trainkos Sh. A. është arritur që ndërmarrja të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2021. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj.

Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2021 i HK - Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Nga fillimi i muajit prill 2019 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimit të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim, do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2021.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2021 kanë qenë në drejtim të realizimit të objektivave të planifikuara për këtë vit si dhe në drejtim të tejkalimit të pengesave dhe vështirësive tjera të ndërmarrjes.

Ndër sfidat e para, me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte çështja mbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve, përkatësisht mungesa e mjeteve për këtë qëllim. Por, viti 2021, gjatë do të mbahet mend për shkak të ndikimit nga pandemia Covid-19, e cilat ka ndikuar edhe tek ne ashtu sikurse në të gjitha bizneset tjera në tërë globin.

Borxhet e akumuluara ndër vite nga transporti i udhëtarëve gjithashtu ishin shqetësuese. Falë punës dhe angazhimit të përbashkët Bord-Menaxhment dhe mbështetjes nga ana e Aksionarit, borxhet e akumuluara ndaj Infrakos, përkatësisht obligimet e qasjes në rrjet nga transporti i udhëtarëve, është arritur që dukshëm të zvogëlohen. Sa i përket transportit të udhëtarëve, përveç çështjes së mbulimit të shpenzimeve, në fokusin tonë ka qenë edhe ngritja e performancës në këtë kategori shërbimesh pas një trendi të vazhdueshëm të rënies të numrit të udhëtarëve. Këto çështje do të jenë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Gjithashtu, aktivitetet dhe angazhimet tjera, gjatë gjithë punës tonë kanë qenë edhe në drejtim të eliminimit të të gjeturave nga auditimi i vitit paraprak dhe gjithashtu edhe në hartimin e dokumenteve strategjike e rregulloreve tjera, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2021**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2021 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Mirëpo, për shkak të gjendjes në ndërmarrje, sidomos nga ndikimi i pandemisë Covid-19, ndërrmarrja ka bërë Rishikimin e Planit të Biznesit 2021.

Në saje të angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, kemi arritur që objektivat e përcaktuara t'i përmbushim në pjesën më të madh të tyre.

Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare gjithashtu ka qenë në fokus të angazhimit tonë dhe nuk kanë munguar përpjekjet tona në këtë drejtim.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2021 HK-Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo shumë të kënaqshëm operativ e

financiar. Relizimi operativ e financiar në transportin e mallrave ka qenë afër objektivave të planifikura, ndërsa krahasuar me realizimin e vitit paraprak kemi pasur realizim dukshëm më të mirë. Te transporti i udhëtarëve realizimi operativ e financiar edhe pse ka qenë afër planifikimit, krahasuatr me vitin paraprak rezultatet janë më të dobëta.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, realizimi është arritur në shkallën prej 82.77 % neto ton mallra të planifikuara për vitin 2021, apo 61 % më shumë se sa vitin paraprak.

Gjithashtu, edhe përformanca financiare nga transporti i mallrave është është arritur në shkallën prej 82.77 % të planifikimit vjetor 2021, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të të hyrave për 52.75 % më shumë.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për 3.85 % më pak në krahasim me vitin paraprak si dhe për 18.9 % më pak se sa planifikimi për vitin 2021.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të të hyrat nga kjo kategori kanë qenë 6.51 % më pak krahasuar me 2020, ndërsa krahasuar me planifikim për vitin 2021 të hyrat kanë qenë prej 14.66 % më pak.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2021 janë shfrytëzuar në masë prej 98% të totalit të tyre.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjithashtu, vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse apo edhe në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e Aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim shpresojmë se do t'ia dalim.

Për këtë qëllim, kemi hartuar edhe Planin Investiv Afatmesëm, në të cilin planifikohet që krahas me zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore të bëhen edhe investimet në mjetet lëvizëse.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2022 siç është rritja e transportit të mallrave vendor dhe ndërkombëtarë si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 523,722.00 € të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 janë shfrytëzuar në disa projekte dhe në shkallën prej 53.41%.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Ndërsa, sa i përket shpërndarjes së **dividentës**, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit (fitimit) për ta ndarë atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 01/96, të datës 02.04.2019. Në bazë të këtij vendimi si dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2021, përkatësisht nga data 12.08.2021, Bordi i Drejtorëve punën e vet e ka zhvilluar në mungesë të një drejtori, pasi që Fejzi Kiqina ka dhënë dorëheqje, i cili gjithashtu ka qenë edhe anëtar i Komisionit të Auditimit.

Duke Pasur parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/96, të datës 02.04.2019, për emërimin e Bordit të HK-Trainkos Sh.A, të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen si në vijim:.

Gjatë vitit 2021 Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje duke llogaritur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2021.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje të Bordit
1	Ramush Ahmetaj	Kryesues	14
2	Agim Preniqi	Anëtar	13
3	Fejzi Kiqina	Anëtar deri më 12.08.2021	8
4	Ylber Shabani	Anëtar	10
5	Mustafa Mustafa	Anëtar	14
6	Ramiz Rrustaj	Anëtar	14
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	14
8	Afrim Kuleta	Sekretar	14

Sipas të dhënave në tabelën më sipër, Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2021, ka mbajtur gjithsej katërmbëdhjetë mbledhje, duke përfshirë edhe Mbledhjen e Përgjithshme me Aksionarin.

II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK-TRAINKOS Sh. A.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2021.

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e Bordit:

Komiteti (koha e funksionimit)		Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 02.04.2019 - aktiv	1	Ramiz Rrustaj	Kryesues	13
	2	Fejzi Kiqina	Anëtar deri më 12.08.2021	7
	3	Agim Preniqi	Anëtar	13
KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 30.06.2020 – 27.05.2021	1	Fejzi Kiqina	Kryesues	2
	2	Ramiz Rrustaj	Anëtar	2

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A
Ramush Ahmetaj – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. A. vitin 2021 arriti që ta përmbyll me një rezultat solid, duke marr për bazë edhe ndikimin e shumë faktorëve të ndryshëm si: shfaqja në përmasa globale e pandemisë së virusit COVID 19, mosfunksionimi normal në transportin e mallrave për shkak të konkurencës jo lojale nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave, qasja vetëm në një portë doganore-linjë ndërkombëtare dhe faktorëve tjerë teknik dhe teknologjik.

Sa i përket ndikimit të pandemisë së virusit COVID 19, ne si ndërrmarrje gjatë vitit 2021 kemi hasur në probleme të mëdha, sidomos në mos realizimi e planifikimeve të deklaruara nga ana e bashëpuntorëve (klientët) tanë, edhe pse gjatë kësaj kohe ne kemi vazhduar të punojm, por me vështirësi të theksuara e që kemi pasur ndikim direkt në (mos) përmbushjen e parashikimeve sipas Planit të Biznesit, e sidomos tremujorin e fundit të vitit 2021 ku si pasojë e krizës energjetike klienti/operatori ynë New Co Feronikeli ndërpreu punën.

Tregu i transportit vendor të mallrave deri diku ka qenë i kënaqshëm në pjesën më të madhe të vitit, sepse me liberalizimin e tregut nuk respektuan rregullat dhe standardet e operimit në transportin hekurudhor. Është krijuar konkurrencë jolojale që ka ndikuar negativisht në përformancen e ndërmarrjes duke pas parasysh që ne si ndërmarrje jemi të obliguar dhe respektojmë të gjitha standardet për operim.

Qasja vetëm në një portë doganore – linjë ndërkombëtare, ka limituar në masë të madhe mundësinë e rritjes së transportit ndërkombëtar të mallrave (export - import).

Aktualisht transporti ndërkombëtar hekurudhor zhvillohet vetëm përmes Maqedonisë së Veriut, por për shkak të punimeve që janë duke u bërë në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" edhe këtu kemi pasur pengesa të mëdha për shkak të vonesave të mëdha që janë duke ndodhur, kufiri në veri qëndron i mbyllur për arsye të ditura politike edhe pse në aspektin teknik linja hekurudhore është e operueshme, ky fakt ka hendikepuar në masë të madhe ndërmarrjen tonë në funksionimin normal në transportin e mallrave duke bërë që shumë klient potencial të orientojnë transportin duke zgjidhur alternativa tjera.

Vazhdojnë të mbetën sfidë, fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Gjithsesi, duke u bazuar në këto rrethana me investime të vazhdueshme që ndikojnë në uljen e shpenzimeve dhe duke u përqendruar në zhvillim të vazhdueshëm të ofertës dhe përmirësim koherent të shërbimit dhe njëkohësisht duke e rritur efikasitetin e strukturës organizative, kemi arritur një përformancë biznesore të kënaqshme, siç do të paraqitet në mënyrë të detajuar në raport.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime t'i përmbush me sukses. HK - Trainkos Sh. A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Përkundër realizimit të disa projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK - Trainkos Sh. A. padyshim mbetet investimi në flotën e mjeteve lëvizëse, ku duke pasur parasysh mjetet që janë ndarë nga buxheti i Kosovës është shumë vështirë që modernizimi të bëhet në masën e kërkuar për operim të rregullt.

Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2021 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme për kompaninë, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i zbatimit të investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh. A.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë.

Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2021

Ngjarjet kryesore më rëndësi të veçantë që e kanë shoqëruar TRAINKOS-in gjatë vitit 2021 janë të paraqitura si në vijim:

- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Obligimin e Shërbimeve Publike (OSHP) 2018 – 2022 për Transportin e Udhëtarëve në linjat hekurudhore të aprovuara paraprakisht dhe pagesa e obligimeve të bartura nga MI-ja nga viti fiskal 2019. Përkundër mosrealizimit të të gjitha linjave dhe kufizimeve me masa qeveritare në transportin e udhëtarëve për shkak të pandemisë COVID 19, është përllogaritur dhe realizuar shuma e humbjeve të argumentuara për këtë shërbim;

- Zbatimi i kontratës dhe vazhdimi i së njëjtës për transportin vendor dhe ndërkombëtarë të xehes së nikelit me klientin kryesorë NewCo Feronikeli. Planifikimi i mire i transportit ndërkombëtar edhe gjatë kufizimeve/mbylljes së linjës Fushë Kosovë-Hani i Elezit, na ka mundësuar realizimin e transportit të planifikuar;

- Vazhdimi i mbështetjes së BE-së për sektorin hekurudhorë përveç iniciativave të ndërmarra nga vitet paraprake përmes DG MOVE dhe SEETO është bërë me Sekretariatin e formuar për zbatimin e "Traktatit për Transport". Nga angazhimet vjetore gjatë vitit 2021 vlen të përmendet diskutimi dhe aprovimi i "Planit të Veprimit" për veprimet që do të ndërmerren. Nga konkluzionet e takimit të fundit gjatë vitit 2021 vlen të përmenden:

    1. Ligji për hekurudha duhet të amandamentohet, i cili tanimë është në planin legjislativ për vitin 2021,
    2. Republika e Kosovës do të bëjë draftin e "Ligjit për Siguri dhe Interoperabilitet", tanimë është në plan legjislativ për vitin 2021 dhe
    3. OShP duhet të ndryshohet me qëllim të përfshirjes së më shumë trenave.

- Zbatimi i projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore", sektori Fushë Kosovë – Hani i Elezit ka filluar në vitin 2019, kompania GCF (Generale Construcioni Ferroviarie S.p.A.) ka filluar zbatimin e projektit. TRAINKOS-i ka identifikuar fushat për bashkëpunim me këtë kompani, ku në mungesë të kufizimeve ligjore për zhvillimin e kësaj veprimtarie nga kjo kompani nuk ka pasur përfitime. Kjo kompani shumicën e transportit të dedikuar përmes hekurudhave e ka bërë me transport e alternative;

- Aktiviteti biznesor me partnerët regjional edhe gjatë vitit 2021, tani më edhe në kushte pandemie ka vazhduar të kufizohet në iniciativa minore për bashkëpunim regjional dhe bilateral me shtetet e regjionit, këto iniciativa janë të kufizuara kryesisht

me shtetin e Maqedonisë së Veriut nëse e kemi parasysh që aktualisht është edhe linja e vetme ndërkombëtare hekurudhore.

- Angazhimin serioz për zhvillimin e sektorit hekurudhorë në Ballkanin Jug – Perëndimorë, BE e ka realizuar gjatë periudhës raportuese, konkretisht ka përgatitur dhe mbajte **"SAMITIN PËR HEKRUDHA 2021 PËR BALLKANIN PERËNDIMORË" më 13 Shtator në Beograd**.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë raport vjetor do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës sonë operative gjatë periudhës vjetore nga 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021, duke prezantuar realizimin e detyrave në Departamentin e Transportit të Mallrave, Departamentit të Transportit të Udhëtarëve dhe Zyrës për Mirëmbajtejen e Mjeteve Lëvizëse, gjithënjë duke krahasuar me planifikimin që është bërë për të njëjtën periudhë me planin e Biznesit të vitit 2021 si dhe duke krahasuar realizimin e vitit paraprak 2020 për të njëjtën periudhë raportuese. Natyrisht do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

IV. 1 DEPARTAMENTI I TRANSPORTI I MALLRAVE

Departamenti i Transportit të Mallrave gjatë kësaj kohe është munduar që të ketë një koordinim të mirë si brenda departamentit ashtu edhe me Departamentin e Transportit të Udhëtarëve, Administratës, Departamentin e Zhvillimit të Bizneseve si dhe Zyrës së Kontrollit ku nga vërejtjet dhe sugjerimet e tyre kemi bërë ndryshime që kanë qenë të mirëseardhura për kompaninë.

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Dhjetor 2021
Realizimi neto Ton në 2020	334,149.83 Ton
Realizimi Neto Ton në 2021	538,012.46 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2021	650,000.00 Ton
Dallimi: Realizim 2021 – Realizim 2020	203,862.63 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2021	-111,987.54 Ton
Dallimi: Realizim 2021 – Realizim 2020 (%)	161.01 %
Dallimi: Realizim 2021 – Planifikim 2021 (%)	82.77 %

Tabela 4.1.1

Siç mund të shihet nga tabela më lartë në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 161.01% më shumë se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar dhe 17.23% më pak se sa sasia e planifikuar për këtë periudhë.

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2021 ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Janar – Dhjetor 2021
Kontejnerë të plotë – 2021	00.00 copë
Kontejnerë të plotë/zbrazët - 2021	00.00 copë

Tabela 4.1.2

Sasia e transportuar në Neto ton për vitin 2021



Figura 4.1.1

Siç mund të shihet nga figura më lartë në aspektin operativ kemi arritur të realizojmë 82.77% nga planifikimi i Planit të Biznesit i rishikuar për periudhën dymbëdhjetë mujore (vjetore) Janar – Dhjetor 2021.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Përshkrimi	Të hyrat për periudhën janar - dhjetor 2021 në €
Realizim shitje të hyra 2020	**715,284.86**
Realizim shitje të hyra 2021	**1,092,660.76**
Planifikimi 2021	**1,320,000.00**
Realizim 2021 - Realizim 2020	**377,375.90**
Realizim – Planifikim 2021	**-227,339.30**
Realizim 2021 - Realizim 2020 (%)	**152.75%**
Realizim – Planifikim 2021 (%)	**82.77%**

Tabela 4.1.3

Siç mund të shihet nga tabela më lartë Neto Ton të shprehura në të hyra me vlerë euro, kemi arritur 82.77% realizim nga planifikimi, për periudhën Janar – Dhjetor 2021 sipas Planit të Biznesit të rishikuar.

Të hyrat në periudhën vjetore 2021




Figura 4.1.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	**1,092,660.76**
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	**40,443.68**
Total shitjet	**1,133,104.44**
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	**1,029,342.56**
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	**503,247.19**
Total shpenzimet	**1,532,589.75**
Fitimi/humbja operative	**-399,485.31**
Fitimi/humbja në %	**-26%**

Tabela 4.1.4

Siç mund të shihet nga tabela më lartë, Transporti i Mallrave ka pasur një humbje prej -399,485.31 euro ose për 26% shpenzime më të larta se të hyrat nga transporti.
Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marre 37% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me tren/kilometra në komunikacion.

Të ardhura të tjera:

RIV dhe vendosje .....34,121.78 **€**
Shërbim i dhënies me qira të lokomotivës për GCF-në .....**6,320.01 €**

Mallrat e transportuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2021

Kemi transportuar mallra të ndryshme dhe nga 100 % i mallrave të transportuara kemi: Xehe e nikelit vendore 76.61%, Xehe e nikelit nga Importi 20.74%, Thëngjill 1.86%, Transport ushtarak 0.23%, Laminat 0.22%, Shina për binarë 0.19%, Mall i përzier 0.11%, Shtylla druri 0.04%.




Figura 4.1.2

Revokimi i Trenave

Më poshtë do ti paraqesim revokimet e trenave të mallrave të ndarë sipas kategorive Import, Eksport dhe Vendorë.

Janar - Dhjetor 2021	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import -Export	144	0	48	39	**10,707.15 €**
Vendor	0	203	146	137	**7,475.11 €**
Total	144	203	194	176	**18,182.26 €**

Tabela 4.1.5

Nga tabela më lartë shihet që gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021 në import dhe eksport janë revokuar në total **231** trena, kjo si pasojë qe nuk ka pasë transport gjatë ditëve kur trenat i kemi te planifikuar me OLT por edhe për shkak të mbylljes 24 orëshe të linjës Miradi – Hani i Elezit për shkak të punimeve në hekurudhë.

Po ashtu nga tabela më lartë shihet që gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021 në transport vendor janë revokuar në total **486 trena**. Prej tyre **203** trena janë revokuar me 10%, **146** trena janë revokuar me 20% dhe **137** trena janë revokuar me 100%.

Revokimet e këtyre trenave në transport vendor kanë ardhur për shkaqe të ndryshme si: vonesat në ngarkim dhe shkarkim të xehes nga ana e klientit NewCo Ferronikeli, vonesa në ngarkim dhe shkarkim për shkak të kushteve atmosferike apo ndonjëherë prishjeve që ndodhnin në depon e klientit, pastaj disa here edhe për shkak të dhënies përparësi të shkarkimit të xehes ndërkombëtarë ndërsa së fundmi janë për shkak të ndërprerjes së punës në fabrikë shkaku i shtrenjtit të rrymës.

IV. 2 DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar.

Duhet të ceket se gjatë periudhës raportuese të gjithë trenat e relacionit të Hanit të Elezit nuk kanë qarkulluar prej vendimit të Institucioneve të Republikës së Kosovës në kuander të masave të Covid 19 prej datës 13.03.2020 e më pastaj edhe për shkak të punimeve në rehabilitimin e linjës hekurudhore Leshak – Han i Elezit projekt i cili është në realizim e sipër. Gjatë periudhës raportuese kanë qarkulluar vetëm trenat e relacionit Prishtine – Pejë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar - Dhjetor 2021 me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Në këtë tabelë shihet se kemi rritje të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i Udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2020	58,819
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2021	61,081
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2021	80,000
Dallimi: Realizim 2021 - 2020	2,262
Dallimi: realizim - planifikimi 2021	-18,919
Dallimi: 2021 - 2020	3.85
Dallimi: realizim - planifikimi 2021	-23.65

Tabela 4.2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të madh të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 3.58 % më shumë dhe 23.65 % më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2020	48,074.52
Realizim shitje të hyra 2021	51,205.25
Planifikimi 2021	60,000.00
Dallimi: realizim 2021 - realizim 2020	3,130.73
Dallimi: realizim - planifikim 2021	-8,794.75
Dallimi: realizim 2021 - realizim 2020	6.51
Dallimi: realizim - planifikim 2021	-14.66

Tabela 4.2.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 6.51 % më shumë sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 14.66 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 4.2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi	Të hyrat (Janar - Dhjetor 2021)
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	1,007,403.78 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	576,278.04 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	51,205.25 €
Të hyrat nga shërbimi i ID kartelave:	200.86 €
Total të hyrat	1,635,087.93 €
Shpenzimet direkte në TU	877,064.32 €
Shpenzimet indirekte në TU	856,880.35 €
Total shpenzimet	1,733,944.67 €
Fitimi / humbja operative	98,856.74 €

Tabela 4.2.3




Figura 4.2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej – **6.00 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 63.00% nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.

IV. 3. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: mirëmbajtja e trenave motorik, lokomotivave transportuese, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve, vagonëve për transportin e mallrave dhe punët tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

IV.3.1 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2019.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2021	2020	Ndryshimi
1.	Servisime	2	10	-8
2.	Riparime	1	15	-14
3.	Kontrollime K1	1	2	-1
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	1	-1
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 4.3.1

IV.3.2 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2021	2020	Ndryshimi
1.	Servisime	462	396	66
2.	Riparime	51	34	17
3.	Kontrollime K1	32	29	3
4.	Kontrollime K3	8	10	-2
5.	Kontrollime K6	9	8	1
6.	Gdhendje te rrotave	2	6	-4

Tabela 4.3.2

IV.3.3 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	2021	2020	Ndryshimi
1.	Servisime	5	3	2
2.	Riparime	9	13	-4
3.	Kontrollime K1	8	5	3
4.	Kontrollime K3	2	0	2
5.	Kontrollime K6	1	1	0

Tabela 4.3.3.1

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë vitit 2021 për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjeti tërheqëse	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
S	57	56	59		41	250	7		2
R	7	13	15		7	5	8		2
K 1	7	6	6		5	7	7		
K 3	2	2	2			1	3		
K 6	2	2	1		1	3	1		
Gdhendje të rrotave									

Tabela 4.3.3.2

S - Servisim,
R - Riparim,
K1 - Kontrollime njëmujor,
K3 - Kontrollime tremujor,
K6 - Kontrollime gjashtëmujor

IV.3.4 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve te udhetareve te realizuara ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2021	2020	Ndryshimi
1.	Kontrollime K1	96	87	9
2.	Riparim në punëtori	55	23	32
3.	Kontrollime në stacion	-	-	-
4.	Gdhendje të rrotave	8	7	1
5.	Testim i komponentave	8	6	2

Tabela 4.3.4

IV.3.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimvev të komponenteve, kontrollimeve dhe riparimeve per mirëmbajtjen e vagoneve te mallrave te realizuara ne vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

	Lloji i riparimit/mirembajtjes	2021	2020	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	71	74	-3
2.	Riparim në punëtori	40	17	23
3.	Riparim në teren	0	2	-2
4.	Gdhendje të rrotave	5	8	-3

Tabela 4.3.5

IV.3.6 Riparimi i vagoneve të huaj

Rriparimi/mirembajtja e vagonëve të huaj	2021	2020
NewCo Feronikeli	**29,454.50 €**	**15,323.10 €**

Tabela 4.3.6

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2021
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2021)
3. Bilanci i gjendjes
4. Transaksionet e realizuara (janar – dhjetor 2021)

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2021, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

V. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 1,092,660.76€ për periudhën janar - dhjetor 2021. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2021 është 1,320,000.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 82.78% nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 457,576.04€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 2,302.79€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "NewCo Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 632,781.93€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2021, është realizuar në shumën prej 1,635,087.93 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,007,403.78 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 576,278.04 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 51,406.11 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit 82.32%, krahasuar me planifikimet e vitit 2021 – 1,986,278.00 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2021, kanë arritur shumën prej 40,443.68 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2021, e cila është 80,000.00 € arrin kuotën prej 45.32 %. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet dhe kontrata me kompanine GCF.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, kanë arritur shumën prej 44,909.87 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siq vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 22,881.33 €, te hyrat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera në vlerë prej 18,126.80 €. Buxheti i planifikuar është 60,000.00 €, shprehur ne përqindjen 74.85 %.

V. 1. 2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar–dhjetor 2021, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 1,136,740.57 € nga 1,339,000.00 € të planifikuara për vitin 2021 dhe arrijnë kuotën prej 84.89 %. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2021.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,821,558.09 €, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,819,532.09 € dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera në vlerë prej 2,026.00 €. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2021 – 1,885,000.00 €, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 96.63 %.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 232,519.72 €, kjo shumë është vetëm 28.74 % nga shuma prej 808,912.48 € e parashikuar vitin 2021. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2021.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 52.06 %, konkretisht në shumën prej 83,822.09 €. Planifikimi per vitin 2021, i kësaj kategorie është 161,000.00 €. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2021.


TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2021

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2021	Buxheti 2021	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor 2020
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	1,092,660.76	1,320,000.00	(227,339.24)	82.78	715,284.86
2	TU – Ministria e Infrastruktures	1,007,403.78	1,350,000.00	(342,596.22)	74.62	1,074,861.90
3	TU – Ministria Ekonomis	576,278.04	576,278.00	0.04	100.00	500,000.04
4	TU – Shitja e Biletave	51,406.11	60,000.00	(8,593.89)	85.68	49,045.04
5	Shërbimet tjera	40,443.68	80,000.00	(39,556.32)	50.55	79,012.34
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	22,028.54	40,000.00	(17,971.46)	55.07	8,956.60
7	Të hyrat tjera jo operative	22,881.33	20,000.00	2,881.33	114.41	18,854.28
I	TOTAL – TË HYRAT	2,813,102.24	3,446,278.00	(633,175.76)	81.63	2,446,015.06
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	562,969.76	633,000.00	(70,030.24)	88.94	352,462.65
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	24,984.39	27,000.00	(2,015.61)	92.53	25,734.69
3	Inventar dhe pajisje	1,177.78	1,000.00	177.78	117.78	1889.41
4	Material harxhues	2,277.97	5,000.00	(2,722.03)	45.56	1032.18
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	28,780.21	80,000.00	(51,219.79)	35.98	25,327.25
6	Qasja në binarë	367,126.58	415,000.00	(47,873.42)	88.46	302,198.04
7	Sigurimi i palëve të treta	1,688.14	3,000.00	(1,311.86)	56.27	1,980.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	123,699.67	150,000.00	(26,300.33)	82.47	51,449.98
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	22,629.86	20,000.00	2,629.86	113.15	18,900.60
10	Servisimi I arkave fiskale	-	5,000.00	(5,000.00)	0.00	3,943.47
11	Zbritjet e lejuara	1,406.21	-	1,406.21	0.00	31499.26
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	1,136,740.57	1,339,000.00	(202,259.43)	84.89	816,417.53
	Fitimi (humbja) bruto	1,676,361.67	2,107,278.00	(430,916.33)	79.55	1,629,597.53
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura të jashtëzakonshme	-	-	-	0.00	600,000.00
2	Zbritjet e mara	-	-	-	0.00	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	237,254.90	235,190.48	2,064.42	100.88	-
4	Te ardhura tjera	-	523,722.00	(523,722.00)	0.00	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	237,254.90	758,912.48	(521,657.58)	31.26	600,000.00
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,819,532.09	1,879,000.00	(59,467.91)	96.84	1,767,532.56
2	Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera	2,026.00	6,000.00	(3,974.00)	33.77	1,576.00
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,821,558.09	1,885,000.00	(63,441.91)	96.63	1,769,108.56
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	17,633.45	678,912.48	(661,279.03)	2.60	15,572.52
2	Sigurimi fizik – total	-	-	-	-	0.00
3	Shërbimet tjera	-	500.00	(500.00)	0.00	4.35
4	Shpenzimet logjistike	20,320.65	13,000.00	7,320.65	156.31	12,315.92
5	Energjia elektrike dhe komunalite	5,288.91	9,000.00	(3,711.09)	58.77	4,224.16
6	Kontrollimet sistematike	2,800.00	5,000.00	(2,200.00)	56.00	0
7	Marketingu	5,101.40	18,000.00	(12,898.60)	28.34	2,681.92
8	Udhëtimet zyrtare	-	3,000.00	(3,000.00)	-	0
9	Telefonat dhe Posta	22,243.47	33,000.00	(10,756.53)	67.40	7,837.35
10	Shërbimet bankare	837.23	1,500.00	(662.77)	55.82	714.35
11	Tatimet	149,033.17	27,000.00	122,033.17	551.97	34,641.06
12	Pajisje elektronike	9,261.44	20,000.00	(10,738.56)	46.31	7,933.09
	TOTAL - Shpenzimet operative	232,519.72	808,912.48	(576,392.76)	28.74	85,924.72

E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	2,073.25	7,000.00	(4,926.75)	29.62	394.24
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	2,238.00	35,000.00	(32,762.00)	6.39	0
3	Material i zyrës	20,828.69	20,000.00	828.69	104.14	9,384.51
4	Material sanitar	3,061.67	10,000.00	(6,938.33)	30.62	6,435.20
5	Qiraja për objektet	15,056.64	15,000.00	56.64	100.38	14,772.69
6	Reprezentacioni dhe bufeja	3,444.49	4,000.00	(555.51)	86.11	3,007.30
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	15,800.81	34,000.00	(18,199.19)	46.47	67,071.35
8	Shpenzimet logjistike	18,508.49	26,000.00	(7,491.51)	71.19	15,168.19
9	Kontigjente	2,810.05	10,000.00	(7,189.95)	28.10	384.2
	TOTAL - shpenzimet administrative	83,822.09	161,000.00	(77,177.91)	52.06	116,617.68
	Provizionet e borgjeve të këqija	-	-	-	-	15,322.65
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	3,274,640.47	4,193,912.48	(919,272.01)	78.08	2,803,391.14
III	Fitimi (Humbja) para zhvlersimit	(224,283.33)	11,278.00	(235,561.33)	(1,988.68)	257,946.57
	GRANTET	982,375.60	975,000.00	7,375.60	100.76	1,078,460.26
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	982,375.60	975,000.00	7,375.60	100.76	1,078,460.26
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	33,186.70	25,000.00	8,186.70	132.75	30,032.27
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	1,015,562.30	1,000,000.00	15,562.30	101.56	1,108,492.53
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(257,470.03)	(13,722.00)	(243,748.03)	1,876.33	227,914.30


Tabela 5.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2021



Diagrami 5.1

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2021



Diagrami 5.2

V. 2 Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës (31.12.2021)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2021
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	281,727.46
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	539.37
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	94,071.15
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	22,149.13
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	0.00
	Totali	**398,487.11**

Tabela 5.2.1

V. 3 Bilanci i gjendjes

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH. A.	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/2021**	**GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.12.2021**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**3,592,240.37**	**2,818,330.52**
Mjetet Qarkulluese	**2,478,044.17**	**2,407,309.23**
Stoqet	454,060.93	432,761.70
Paraja	428,590.99	400,287.08
Llogarite e arketueshme	1,160,639.64	1,159,868.05
Kerkesa tjera te arketushme	413,503.05	393,807.16
Parapagimet	21,249.56	20,585.24
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**6,070,284.54**	**5,225,639.75**
Detyrimet afatshkurta	**1,396,590.77**	**1,473,095.79**
Llogarite e pagueshme	782,010.22	863,568.07
Te pagueshme tjera - detyrime	6,188.23	1,089.77
Detyrime tatimore	608,392.32	608,437.95
Llogarite tjera	-	-
Detyrimet afatgjata	**1,397,666.08**	**695,019.57**
Kapitali	**5,289,327.94**	**5,289,786.12**
Fitimi/Humbja e bartur	-2,245,015.47	(1,974,791.70)
Fitim/ Humbja e vitit	231,715.22	(257,470.03)
Total detyrimet dhe kaptali	**6,070,284.54**	**5,225,639.75**

Tabela 5.3.1

V.4 Transaksionet e realizuara (2021)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2021	115,872.30
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2021	1,918,342.65
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2021	1,752,487.49
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2021	281,727.46

Tabela 5.4.1

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2021	521.37
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2021	279,728.89
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2021	279,711.39
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2021	539.37

Tabela 5.4.2

VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK - TRAINKOS SH. A.

Të gjitha projektet janë të financuara nga Buxheti Operativ i Trainkos Sh.A., përveç projektit nen numrin rendor 9 me vlere te kontraktuar prej 328,744.98 € i cili projekt është i financuar me buxhetin e Kosovës si projekt kapital i përfshirë ne Marrëveshjen e Monitorimit dhe Kontrollit.

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Shërbimet e zbrazjes së rezervarëve nga ujërat e zeza nga vagonët e udhëtarëve	**Janar**	3,000.00	2,916.00	Implementim
2	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	**Mars**	2,000.00	1,992.00	Përfunduar
3	Hartimi i projektit të nxemjes për objektet e Trainkos Sh.a.	**Prill**	900.00	889..20	Përfunduar
4	Furnizimi me material harxhues	**Shkurt**	700.00	600.00	Përfunduar
5	Furnizimi me tavolinë pune dhe karrige	**Shkurt**	700.00	500.00	Përfunduar
6	Furnizimi me material për zyre ligjore	**Janar**	500.00	466.60	Përfunduar
7	Blerja e gypit 30 m dhe dorezës së makinës autolarjes	**Mars**	300.00	230.00	Përfunduar
8	Furnizimi me ormanë metalik	**Mars**	600.00	520.00	Përfunduar
9	Renovimi i objektit të Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse	**Korrik**	335 960,00	328,744.98	Implementim
10	Sigurimi i automjeteve të kompanisë	**Maj**	3,500.00	3,385.90	Implementim
11	Furnizim me vaj për lokomotiva	**Maj**	8,000.00	7,072.00	Përfunduar
12	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative	**Qershor**	6,000.00	4,621.00	Përfunduar
13	Furnizim me printer për punimin e ID kartelave për transportin e udhëtarëve	**Maj**	1,600.00	1,180.00	Përfunduar
14	Kontrollimet sistematike shëndetësore të stafit të Trainkos Sh.a.	**Maj**	10 000,00	10,000.00	Implementim
15	Furnizimi me switch dhe testues për kabull	**Shkurt**	700.00	510.00	Përfunduar
16	Shërbimet e shtypjes se OLT-së	**Shkurt**	700.00	690.00	Përfunduar
17	Furnizimi me bateri për lokomotivë	**Shkurt**	350.00	299.26	Përfunduar
18	Furnizim me inventar	**Mars**	350.00	275.00	Përfunduar
19	Furnizim me bateri elektrike-dore	**Mars**	400.00	299.00	Përfunduar
20	Furnizim me pajisje të MML	**Mars**	300.00	240.00	Përfunduar
21	Furnizim me drita neon	**Mars**	300.00	245.00	Përfunduar
22	Furnizimi me bateri për lavaman dhe gypa	**Mars**	250.00	200.00	Përfunduar
23	Furnizim me karrige	**Maj**	400.00	330.00	Përfunduar
24	Servisimi i 3 gjeneratorëve	**Maj**	950.00	829.50	Përfunduar
25	Furnizim me material për nxemje	**Qershor**	250.00	214.00	Përfunduar
26	Furnizim me tepison për objektin e tërheqjes	**Korrik**	400.00	349.56	Përfunduar
27	Furnizim me toner	**Korrik**	6,000.00	4,269.00	Implementim
28	Rregullimi i automjetit Hyundai Sonata TG.01-490-BB	**Tetor**	950.00	950.00	Përfunduar
29	Furnizimi me reflektor për objektet e	**Tetor**	350.00	350.00	Përfunduar

	Trainkos Sh.a.				
30	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	**Tetor**	4,500.00	4,433.00	Implementim
31	Shërbimet e kënaqshmerisë se klientëve	**Shtator**	990.00	683.00	Implementim
32	Mbikëqyrja e punimeve në objektin e MML-së	**Shtator**	950.00	910.00	Implementim
32	Riparimi i gjeneratorit të trenit ndihmës	**Dhjetor**	650.00	640.00	Përfunduar
33	Furnizimi me material për zbrazjen e rezervarëve të Vagonëve	**Dhjetor**	380.00	377.56	Përfunduar
34	Shërbimet e shtypjes së materialit të marketingut	**Dhjetor**	995.00	993.56	Përfunduar
35	Furnizimi me kompjuter dhe bateri UPS për nevoja e stafit	**Dhjetor**	880.00	724.00	Përfunduar
36	Mbushja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	**Dhjetor**	650.00	628.00	Përfunduar
37	Furnizimi dhe vendosja e gomave te dimrit ne automjetet e Trainkos Sha	**Dhjetor**	770.00	762.00	Përfunduar
38	Furnizim me ventila sigurues hyrës dhe dalës për vinça hidraulik LUKAS	**Nëntor**	6,700.00	5,660.00	Implementim
39	Furnizim me shendrrues të tensionit	**Nëntor**	7,300.00	4,510.80	Implementim
40	Furnizimi dhe montimi i klimave për objektin e Tërheqjes	**Nëntor**	1,500.00	1,260.00	Implementim
41	Furnizim me bllomba për Depart e Transportit te Mallrave	**Nëntor**	918.24	900.00	Përfunduar
42	Furnizimi me nxemse për nevojat e stafit	**Tetor**	600.00	258.00	Përfunduar
43	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	**Tetor**	1,610.00	980.00	Përfunduar
44	Furnizimi me material administrativ	**Tetor**	5,200.00	4,992.50	Implementim
45	Furnizimi me rërë për lokomotiva	**Tetor**	3,000.00	2,478.00	Përfunduar
46	Furnizimi me vajra dhe lubrifikante	**Shtator**	63,000.00	39.95[1]	Implementim
47	Furnizimi dhe instalimi i materialit elektrik ne objektin e pastrimit	**Korrik**	1,500.00	1,380.00	Përfunduar
48	Furnizim me karrige lëvizëse për stafin e Kompanisë	**Tetor**	3,000.00	2,247.00	Përfunduar
49	Furnizim me material ndërtimor	**Tetor**	750.00	689.40	Përfunduar

Tabela 6.1

[1] Çmimi i dhënë është në bazë të poentimit. Totali i parashikuar për shpenzim është 63,000 € për dy vite kalendarike

VII. ZHVILLIMI I BIZNESIT

VII.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

TRAINKOS-i veprimtarinë e vetë e bazon nga pritjet për vitin përkatës, konkretisht për vitin 2021 karakterizohet me pritjet në zbatimin e reformave të shumëpritura në sektorin hekurudhorë, vazhdimin e zbatimit të projektit për Modernizimin e linjës së 10-të hekurudhore (finalizimi i sektorit Jugorë dhe fillimi i sektorit Veriorë), masat e propozuara dhe iniciativat e ndërmarra nga BE-ja me funksionalizimin e Sekretariatit të Traktatit për Transport për zhvillimin e sektorit Hekurudhorë në Ballkanin Jug – Perëndimorë.

Me fillimin e vitit 2021 është bërë plotësimi i detyrave dhe obligimeve sipas planit të punës të përgatitur në fillim të vitit në periudha tremujore. E tëra është bazuar në dokumentin e "Strategjisë Afatmesme të Investimeve për TRAINKOS-in 2020 - 2024". Me këtë Strategji do të definoheshin politikat zhvillimore të TRAINKOS-it të koordinuara me Qeverinë dhe pjesëmarrësit tjerë të sektorit hekurudhorë. Njëkohësisht do të koordinohet edhe qasja tek IFN-të në koordinim me ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Projektet e kësaj forme duhet të kenë aprovimin e institucioneve relevante shtetërore për të mbështetur projektet në procedurat e mëtutjeshme në Western Balkan Investment Framework (WBIF, Kornizën e Investimeve në Ballkanin Jug – Perëndimorë) apo Instrument for Pre Accession (IPA, Instrumente të Para Anëtarësimit) fonde apo nga burimet vetjake të ndonjë IFN-je. Me këto veprime do të krijohen parakushtet për identifikimin e burimeve financiare për të ripërtëri / furnizua me mjete lëvizëse të reja flotën e mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra të TRAINKOS-it.

Për aktivitete e sipërpërmendura përkundër ngecjes të proceseve me periudhën e pandemisë COVID – 19 dhe ndërrimeve të shpeshta të Qeverisë janë bërë veprime të domosdoshme për definimin e prioriteteve dhe masave që duhet të ndërmerren në vitet në vijim. Sekretariati i zyrës për Zbatimin e Traktatit për Transport ka mbajte takime (Online) me shtetet e Evropës Jug –Lindore, pra edhe me shtetin e Republikës së Kosovës. Rezultat i kësaj pune është Plani i Veprimit që definon detyrat dhe obligimet që merr secili shtet nga reformat zhvillimore të udhëhequra dhe mbështetur nga BE-ja.

Angazhimin serioz për zhvillimin e sektorit hekurudhorë në Ballkanin Jug – Perëndimorë BE e ka realizuar gjatë periudhës raportuese, konkretisht ka përgatitur dhe mbajte "SAMITIN PËR HEKRUDHA 2021 PËR BALLKANIN PERËNDIMORË" më 13 Shtator në Beograd

Në këtë takim kanë marrë përveç Komunitetit të Transportit nga tërë regjioni edhe Niveli i lartë i përfaqësuesve të BE-së, BERZh-it dhe BEI-së. Serioziteti tregohet me zotimet e bëra paraprakisht për investime dhe objektivit të përbashkët për të vepruar në vendosjen e Hekurudhave në objektiv primar për më tepër, besimi që Samiti ishte vetëm fillimi drejt krijimit të fondit solid për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit hekurudhorë të regjionit.

Punët në realizimin e projektit në Modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore dhe planifikimet në Modernizimin e Linjës Lindje–Perëndim janë në vlug përkundër ndërprerjeve sipas masave anti COVID, parashikimet kanë qenë që sesioni Jug (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) të përfundojnë brenda vitit 2021, mirëpo për shkak të vitit me Covid ky afat është vazhduar për 300 ditë, fundi i vitit 2022. Me këtë do të krijon parakushte për shtrirjen e rrjetit hekurudhorë në pjesën kah kalon ky rrjetë (linjat ekzistuese hekurudhore) do të plotësojë parakushtet për Linjat e reja që janë paraparë me planifikimet strategjike afatgjata të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rëndësi të veçantë ka vazhdimi i Linjës hekurudhore nga Prizreni për Shqipëri, realizimi i kësaj lidhje do të mundëson edhe qasjen në Portet e Shqipërisë. Këtë iniciativë e ka potencua edhe Ministri i MMPHI në Samitin e Beogradit të datës 13 Shtator, 2021. Kjo do mundësojë që të avancojë qarkullimin e mallrave me tren jo vetëm për Republikën e Kosovës por edhe shtetet tjera në kontinent nga Portet gjeografikisht strategjike të Shqipërisë. Paralajmërimet për investime në Portin e Durrësit dhe iniciativat për fillimin e punëve për lidhjen me Kosovën e tutje kërkon reformim në sektorin hekurudhë në Kosovë. TRAINKOS-i duhet të përshtatë veprimet strategjike me këto ndryshime të rëndësishme.

Kërkesat nga MMPHI-së për plotësimin e të dhënave të transportit për nevojat e Sekretariatit të Traktatit për Transport janë plotësuar. Mundësia e përfitimit nga procedura e tjetërsimit të 25 seteve të trenave motorik nga Holanda është përcjellë tek përgjegjësit në MMPHI. Përkundër përsëritjes së kërkesës nuk kemi ndonjë përgjigje se a do të procedohet me procedura që do të i mundësonte TRAINKOS-it të i ketë në flotën e sajë këto mjete lëvizëse të përdorura por në gjendje shumë të mirë teknike. Një mundësi e mirë është shpërfillur, problemet e mjeteve lëvizëse mbesin të hapura si për TU ashtu edhe për TM. Revizioni i vagonëve të udhëtarëve kërkon zgjidhje urgjente nëse e kemi parasysh përfundimin e Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 dhe përgatitjet për Marrëveshjen e re pesë vjeçare, flota e lokomotivave paraqet problem në vete.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për kompaninë Feronikel nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas është bërë sipas marrëveshjes së nënshkruar, Transporti vendor dhe ndërkombëtar ka vazhduar sipas planifikimi edhe përkundër problemeve në modernizimin e linjës sidomos të transportit ndërkombëtarë. Mirëpo problemet e ngritura dhe ndalja e prodhimit për shkak të furnizimit me energji elektrike është shqetësuese edhe për planifikimet afatshkurtra të kompanisë, ky problem nuk parashihet të zgjidhet në tre mujorin e parë të vitit 2022. Paralajmërimi i transportit të thëngjillit nga KEK-u dhe koncentratit / mbetjeve xeherore nga “Trepça” janë duke u diskutuar me palët përgjegjëse të përfshira në këtë proces.

Zbatimi i Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 është në vitin e katërt të zbatimit. Vitit 2020 dhe ndarjet buxhetore për vitin 2021 tregojnë finalizimin e një procesi të gjatë për zbatimin e kësaj forme të kompensimit të humbjeve nga transporti i udhëtarëve. Konkretisht është buxhetuar shuma e mjaftueshme për mbulimin e humbjeve për linjat e aprovuara (6 sosh në fillim të vitit 2020 dhe 4 nga fillimi i masave anti Covid dhe Modernizmi i Linjës së 10-të hekurudhore – sesioni Jug).

VII.2 Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera

Periudha raportuese Janar – Dhjetor rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), ARH-në, Ministrinë e Ekonomisë (ME), ESK (Enti Statistikorë i Kosovës), BEI dhe BERZh.

- Është caktuar Komisioni për çregjistrimin e mjeteve lëvizëse të tjetërsuara në pronësi të "TRAINKOS-it" për procedim me ARH-në, angazhimi vazhdon në gjetjen e modaliteteve për përfundim të kësaj detyre;

- Me Komisionin e MMPHI-s për zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022, për vitin 2021 janë përcaktuar kriteret dhe është filluar me faturimin në baza mujore;

- MMPHI-së ju janë përcjell statistikat e nevojshme për nevojat e Sekretariatit të Zbatimit të Traktatit për Transport;

- Së bashku me MMPHI dhe faktorët tjerë qeveritarë janë mbajte takime virtuale sipas planit të Sekretariatit;

- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me MMPHI;

- Me datën 29.09.2021 në hapësirën e MMPHI-së është mbajte takimi i përbashkët për dokumentin " Deklarata e Rrjetit 2022";

- Me kërkesën e ARH-së është përgatitur dhe dërguar lista e makinistëve aktiv të dokumentuar me certifikatë mjekësore;

- Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-së duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;

- Trainkos është pjesë përbërëse në përgatitjen e draftit të "Planit Nacional për Interoperabilitet – Infrastruktura";

- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese sipas kërkesës, nga fillimi i vitit 2021 raportimet i bëjmë në baza mujore sipas marrëveshjes;

- Për rastet e aksidenteve dhe incidenteve KHAIA-s ju është dërguar dokumentacioni i nevojshëm sipas kërkesës.

VII.3 Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH.A., edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkese që kanë në drejtim të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij tremujori edhe përkundër pandemisë janë zhvilluar kontakte dhe takime me klient potencial, me të cilët janë shqyrtuar mundësit e realizimit të transportit me hekurudhë.

Janë zhvilluar shumë aktivitet informuese lidhur me parandalimin e pandemisë Covid 19 e cila është zhvilluar në trena të udhëtareve dhe në rrjetet sociale

Po ashtu nuk kanë munguar edhe aktivitet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

VII.4 Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Për CIT (International Rail Transport Committee) raportimet vazhdojnë të bëhen në baza vjetore. Fillimi i vitit 2021 ka rezultuar me veprime konkrete nga përgjegjësit e Sekretariatit për Zbatimin e Traktatit për Transport. Nga kontaktet dhe veprimet e ndodhura kemi shkëmbyer statistika dhe informata nga ana e jonë, kurse Draft planin e veprimit nga Sekretariatit e kemi pranuar për shqyrtim dhe veprim.

VII.5 Sfidat kryesore gjatë vitit 2019 dhe veprimet për të ardhmen

Gjatë periudhës raportuese, si kompani vazhdojmë të ballafaqohemi me shumë sfida:

1. Rëniet e numrit të udhëtarëve për arsye të pandemisë Covid 19 dhe probleme tjera;
2. Ballafaqimi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit;
3. Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e plotë të shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OShP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASh 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik;
4. Restrikcionet e vendosura nga Maqedonia Veriore për transport të minimum 6 vagonëve që vijnë në drejtim të Kosovës;

5. Kriza energjetike, ndërprerja e transportit të xehes;
6. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
7. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
8. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
9. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
10. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
11. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
12. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
13. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
14. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv.

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.


Edhe në vazhdim ne mbetemi të përkushtuar dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH. A. në vitin 2021 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2020. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2021, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e Kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK – Trainkos SH.A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos SH.A. më 1 Janar 2021 dhe më 31 Dhjetor 2021					
Totali i të punësuarve	01.01.2021		31.12.2021		
	227		227		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Data	01.01.2021	31.12.2021	01.01.2021	31.12.2021	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.66	46.60	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	227	227	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të paafatizuar	74	61	32.59 %	26.87 %	
Me kontratë të afatizuar	153	166	67.40 %	73.12 %	
Meshkuj	200	198	88.10 %	87.22 %	Gjinia
Femra	27	29	11.89 %	12.77 %	
Serbë	2	2	0.88 %	0.88 %	Nacionaliteti.
Shqiptarë	225	225	99.11 %	99.11 %	
Me shkollim fillor	13	10	5.72 %	4.40 %	Shkollimi
Shkollim të mesëm	126	127	55.50 %	55.94 %	
Kualifikim profesional	24	24	10.57 %	10.57 %	
Me shkollim të lartë	2	2	0.88 %	0.88 %	
Me shkollim superior	62	64	27.31 %	28.19 %	
Zyrtarët e Lartë	4	4	1.76 %	1.76 %	
Kabineti i Kryeshefit Ekzekutiv	3	3	1.32 %	1.32 %	
Departamenti i Transportit të Mallrave	48	48	21.14 %	21.14 %	
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	60	60	26.43 %	26.43 %	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Administratës	50	49	22.46 %	21.58 %	
Departamenti i Financave	11	9	4.84 %	3.96 %	
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	6	6	2.64 %	2.64 %	
Departamenti i Prokurimit	3	4	1.32 %	1.76 %	
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	18	20	7.92 %	8.81 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	2	2	0.88 %	0.88 %	
Zyra e Mirëmbajtjes së Lokomotivave dhe Trenave Motorik	19	19	8.37 %	8.37 %	
Zyra Ligjore	3	3	1.32 %	1.32 %	

Tabela 8.1

Sqarim: *Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021 kemi pasur 10 punësime, 4 pensionime, 4 ndërprerje të marrëdhënies së punës, 2 raste të vdekjes së punëtorëve. Në këtë tabelë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.*

IX. ZYRA LIGJORE

IX.1 Kontestet gjygjësore

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2021, nga zyra ligjore e ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës që lam pas, pranë Gjykatave Themelore kanë qenë të caktuara **33** seanca gjyqësore për proceset në të cilat kemi qenë palë në procedurë qoftë në cilësinë e të padituresë apo të paditëses.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja në procedurë gjyqësore ka pasur 10 konteste për kompensim dëmi, 2 konteste për pagim borxhi, 2 konteste të punës, 1 kontest në procedurë administrative dhe 5 konteste në procedurë përmbarimore. 13 lëndë kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, prej tyre 6 në Gjykatë të Apelit të Kosovës dhe 4 në Gjykatë Supreme të Kosovës, ndërsa 1 është kthyer në rigjykim me vendim të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe 1 ka përfunduar me vendim të Gjykatës Themelore, por e njëjta prapë është duke u gjykuar për shkak se është kthyer në gjendjen e mëparshme po me vendim të gjykatës, 2 konteste kanë përfunduar në procedurë të përmbarimit me vendim të përmbaruesit. 4 lëndë të tjera është nxjerr aktgjykim nga Gjykata Themelore dhe procedura ka vazhduar në Gjykatën e Apelit.

Prej **13** lëndëve të përfunduara gjatë periudhës kohore janar - shtator 2021, me vendime të formës së prerë ndërmarrja jonë është obliguar që të paguajë në emër të kompensimeve, shpenzimeve të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore 15,800.81 euro. Ndërsa nga fitimi i padisë për pasurim pabazë ndaj "Rail Pro" sh.p.k ndërmarrja vetëm nga kërkesa kryesore do të përfitoj 47,311.40 euro duke mos llogaritu edhe kamatën ligjore prej 8% e cila do të realizohet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në realizimin e tërësishëm të borxhit.

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar dy padi të reja lidhur me aksidentet e komunikacionit si dhe një Propozim për Përmbarim për mos pagesë të faturës.

Pranë Përmbaruesit Privat është nënshkruar marrëveshja me kreditorin "Infrakos" sh.a, lidhur me lëndën P.nr.17/2017, me borxh lëndor si në propozim për përmbarim prej 827,259.27 euro, i përmbaruar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr,2425/2020, për pagesën e borxhit të mbetur në vlerë prej 387.563.33 euro, i barazuar 06.05.2021 në mes të debitorit dhe kreditorit, i cili do të paguhet në 12 këste mujore në vlerë prej 32, 297.28 euro para datës 31 të çdo muaji deri në përfundim të pagesës së fundit në llogarinë e kreditorit "Infrakos" sh.a e cila është e njohur për debitorin "Trainkos" sh.a. Shpenzimet e përmbarimit të caktuara në vlerë prej 11,886.44 euro sipas Udhëzimit Administrativ 06/2014 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimet e Përmbaruesit Privat do ti paguaj debitori. Debitori dhe Kreditori janë pajtuar që kreditori të hekë dorë nga kamata ligjore e cila arrin shumën afërsisht 240,000.00 euro dhe kjo nënkupton se kemi arritur një marrëveshje shumë të favorshme për ndërmarrjen. Marrëveshja është duke u implemetuar dhe janë paguar deri me tani 7 këste në shumë prej 226,080.96 euro dhe shpenzimet e përmbarimit.

Pas përfundimit të procedurës nga Përmbaruesi Privat Eset Murati lidhur më lëndën përmbarimore P.nr.992/14 të debitorit N.T.SH. Ballkan Shped është filluar procedurë e re, ku me datë 05.05.2021 është dorëzuar Propozimi për Përmbarim të Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, për debitorin N.T.SH. Ballkan Shped, i cili ka marr numër të lëndës P.nr.638/21, datë 05.05.2021 dhe nga i njëjti është pranuar Specifikacioni për shpenzimet e veprimit dhe administrimit të lëndës P.nr.638/21 të cilat janë paguar.

Përkundër faktit se ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj e sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve në të gjitha rastet e aksidenteve të komunikacionit hekurudhor prej të cilave konteste një numër i konsiderueshëm janë trashëguar nga ish Hekurudhat e Kosovës sh.a., në një mënyre ndërmarrja jonë ka arritur që një situatë të tillë ta menaxhojë me sukses.

IX.2 Rreziqet nga kontestet gjygjësore për vitin 2021

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. në vitin 2021, pritet të ballafaqohen me **53** konteste gjyqësore.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre e të cilat mund të përfundohen gjatë vitit 2021:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	//////////
1.	**Kontestet e marrëdhënies së punës**	**10**
2.	**Kontestet për kompensim të dëmit**	**23**
3.	**Kontestet për pagimin e borxhit**	**4**
4.	**Kontest nga Konflikti Administrativ**	**1**
5.	**Lëndë në procedurë përmbarimore**	**15**
6.	**Totali**	**53**

Tabela 9.1

XI. PËRFUNDIM

TRAINKOS Sh. A. edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar të funksionoj sipas planifikimeve të prezantuar dhe aprovuara me Planin e Biznesit 2021. Pengesat për zhvillimin e biznesit vazhdojnë të ndikohen nga faktorë të ndryshëm. Rrethanat e krijuara dhe sfidat që përcjellin kompaninë që nga fillimi, por edhe paraqitja e pandemisë me virusin COVID 19 gjatë vitit 2021 kanë ndikuar mjaft shumë në operimin e rregullt në ofrimin e shërbimit në transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse apo edhe fushëveprimet tjera të cilat janë vitale për një funksionim normal të kompanisë.

Ministritë përkatëse: MMPHI, ME dhe MFPT mbesin faktorë të jashtëm domethënës në zhvillimin e veprimtarisë dhe proceseve të ndodhura gjatë viteve pas procesit të ndarjes.

Politikat e aprovuara me Strategjitë përkatëse për sektorin hekurudhorë nuk janë zbatuar sipas planit të veprimit.

Me fillimin e zbatimit të projektit për modernizimin e sektorit Fushë Kosovë – Hani i Elezit rrit shpresat që Qeveria (aksionari 100% i TRAINKOS-it) të filloj të koordinojë veprimet edhe me zhvillimin e Operatorit hekurudhorë nëpërmes investimeve duke rritur kualitetin e punës dhe pasurimin e flotës me mjete lëvizëse.

TRAINKOS-i funksionon sipas strukturës organizative të aprovuar nga instancat përgjegjëse në bazë të gjendjes aktuale të transportit të mallrave dhe udhëtarëve por me zhvillimet që parashihen do të përkujdeset që të ketë staf profesional që mundëson krijimi i kushteve për siguri në punë dhe plotësimi i të gjitha kushteve tjera për transport të sigurt.

Procesi i avancimeve në sistemin hekurudhorë me planifikimet strategjike për kontinentin nga BE-ja, funksionalizimi i tërë Rrjeti Bazik Hekurudhorë të Evropës dhe kërkesat që vijnë nga nevoja për reformim të këtij sistemi në Evropën Jug Lindore kërkojnë përgatitje adekuate për kompaninë. Kjo nëse e kemi parasysh nevojën e planifikimeve të furnizimit me mjete lëvizëse adekuate sipas trendit të modernizimit të linjave hekurudhore dhe rritjes së vëllimit të transporti në dhe mbrenda vendit. Pastaj është dhe do të jetë sfiduese plotësimi i kritereve të Interoperabilitetit përmes TSI dhe plotësimi i kritereve / kërkesave që vijnë përmes Planit të Veprimit për Mekanizmin Stabilizim Asociim (PVMSA) dhe kërkesat tjera që TRAINKOS - i duhet të i plotësoj si pjesë përbërëse e sistemit hekurudhorë të Republikës së Kosovës.

Veprim urgjent nevojitet kur kemi të bëjmë me Licencimin e punëtorive (në posedim të TRAINKOS-it), tani sipas Rregullores së lëshuar nga ARH-ja (Rregullorja Nr.01/2019 për verifikimin e entiteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave, (datë 28.06.2019) që plotëson standardet e kërkuara nga ERA. Kjo vjen sipas kërkesës që vjen nga BE-ja përmes SEETO-s me mekanizmin e PVPE-së e që ka të bëjë me përpilimin dhe futjen në funksion të legjislacionit dytësorë për sektorin hekurudhorë, konkretisht licencimin për

mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore. Disa shtete në regjion kanë vepruar me shpejtësi dhe janë Licencuar, e për këtë duhet të fillohet me përcaktimin dhe zbatimin e detyrave që rrjedhin për këtë proces mbrenda kompanisë (stafi, punëtoritë, pajisjet dhe të tjera) në të gjitha punëtoritë e TRAINKOS-it.

Përkushtimi i përhershëm mbetet në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve tona për klientët tanë.

Fushë Kosovë,

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala